# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6973
E shtunë, 19 gusht 2023
Çmimi 0.40 €


## Kompensimi i munguar për vdekjen në vendin e punës

FAQE 8




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


TRE TË ARRESTUAR TË DYSHUAR PËR KEQPËRDORIM TË REZERVAVE SHTETËRORE FAQE 4-5

# OPOZITA KËRKON ZGJEDHJE TË REJA PAS ARRESTIMEVE NË MINT DHE PERSONAVE TË AFËRT ME PUSHTETIN




Policia e Kosovës ka arrestuar të premten tre persona të dyshuar se kanë bërë keqpërdorime gjatë blerjeve të rezervave shtetërore në lidhje me aferën “Vaji”. Dy prej të arrestuarve janë zyrtarë të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), ndërkaq njëri afarist, pronar i restorantit “Bukë e Zemër”, i cili, sipas gazetës “Nacionale” që ka raportuar për këtë skandal, është i mik i ngushtë i kryeministrit Albin Kurti. Të arrestuarve u është caktuar masa e mbajtjes për 48 orë. Pas këtyre arrestimeve përfaqësuesit e partive opozitare kanë theksuar se kjo qeveri duhet të rrëzohet e vendi sa më shpejt duhet të shkojë në zgjedhje të reja

## QKUK-JA: NJËMBËDHJETË RASTE ME MENINGJIT PO TRAJTOHEN NË KLINIKËN INFEKTIVE, SITUATA ËSHTË NË KONTROLL

FAQE 7




## NUMRI I POLICËVE SERBË TË DORËHEQUR ARRIN NË SHTATË, OSMANI: PRES NGA BE-ja TË NDËRMARRË MASA

FAQE 3



## AKTUALE



### OBSH-JA PO E VËZHGON NJË VARIANT TË RI TË KORONAVIRUSIT F. 2

### RAMA: NË DISA LAGJE TË PRISHTINËS KA RËNË NUMRI I VJEDHJEVE F. 6

### TETË APARATURA TESTIMI PËR PCR I JANË DHURUAR IKSHPK-së F. 7

## EKONOMI



### HAPEN THIRRJET PËR SUBVENCIONIM TË PAJISJEVE SHTËPIAKE EFIÇIENTE DHE SISTEMIT DIELLOR PËR NGROHJEN E UJIT SANITAR F. 8

## SPORT



### ADEMI TAKON DREJTUESIT E FIFA-S, BISEDOJNË PËR PROJEKTET E PËRBASHKËTA F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# OBSh-ja po e vëzhgon një variant të ri të koronavirusit

GJENEVË, 18 GUSHT - Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe autoritetet shëndetësore amerikane kanë thënë të premten se janë duke e vëzhguar një variant të ri të koronavirusit, ndonëse ndikimi i tij potencial nuk dihet.
OBSh-ja e ka klasifikuar variantin e ri si nën vëzhgim "për shkak të numrit të madh (më shumë se 30) të mutacioneve që bart", është thënë në buletinin e kësaj organizate për pandeminë.
Deri më tani varianti i ri BA.2.86 është identifikuar në Izrael, Danimarkë dhe Shtetet e Bashkuara.
Qendrat amerikane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve, kanë thënë, po ashtu, se janë duke e vëzhguar variantin.
Shumica e shteteve që kanë krijuar sisteme vëzhgimi për këtë virus tashmë i kanë pezulluar të gjitha operacionet, duke thënë se koronavirusi nuk është më aq i ashpër dhe nuk ia vlen barra qiranë - veprim që është dënuar nga OBSh-ja, duke bërë thirrje për më shumë monitorim.
Në periudhën e fundit raportuese, në periudhën 17 korrik - 13 gusht, janë regjistruar më shumë se 1.4 milion raste të reja me koronavirus, me mbi 2 300 të vdekur, sipas një deklarate të OBSh-së.
Kjo shifër e infektimeve përbën rritje prej 63-përqindësh në krahasim me periudhën paraprake 28-ditore, përderisa shifra e viktimave është 56 për qind më e vogël.
Për koronavirusin e ri është raportuar për herë të parë në dhjetor të vitit 2019 në Vuhan të Kinës.
Organizata Botërore e Shëndetësisë e pati shpallur



koronavirusin pandemi më 11 mars të vitit 2020.
Më shumë se 6.9 milionë njerëz kanë vdekur që prej shpërthimit të pandemisë në gjithë botën.
Shtetet e Bashkuara kanë regjistruar numrin më të madh të viktimave, të përcjella nga India dhe Brazili.

# ShBA-ja miraton dërgimin e aeroplanëve F-16 në Ukrainë përmes Danimarkës dhe Holandës

UASHINGTON, 18 GUSHT - Shtetet e Bashkuara e kanë miratuar dërgimin e aeroplanëve luftarakë F-16 në Ukrainë nga Danimarka dhe Holanda, ashtu që vendi të mbrohet nga pushtuesit rusë, në momentin kur përfundon trajnimi i pilotëve, ka thënë një zyrtar amerikan. Ukraina ka kërkuar vazhdimisht që të pajisjet me aeroplanët amerikanë F-16 për ta luftuar ushtrinë ruse edhe nga ajri.
Uashingtoni u ka dhënë garanci zyrtare Danimarkës dhe Holandës se Shtetet e Bashkuara do ta përshpejtojnë miratimin e kërkesës për dërgimin e aeroplanëve në Ukrainë sapo të përfundojë trajnimi i pilotëve, ka



thënë ky zyrtar, pa u identifikuar.
"Ne e mirëpresim vendimin e Uashingtonit për ta hapur rrugën drejt dërgimit të aeroplanëve luftarakë F-16 në Ukrainë", ka thënë ministri i Jashtëm holandez, Wopke Hoekstra. "Tani ne do ta diskutojmë këtë çështje me partnerët tanë evropianë".
Edhe Danimarka ka thënë se do ta diskutojë këtë çështje. "Qeveria e ka thënë disa herë se donacioni është hap i natyrshëm pas trajnimit. Ne jemi duke e diskutuar këtë gjë me aleatët e ngushtë dhe pres që shumë shpejt të jemi më konkretë", ka thënë ministri danez i Mbrojtjes, Jakob Ellemann-Jensen.
Një koalicion prej 11 shtetesh pritet ta nisë trajnimin e pilotëve ukrainas për përdorim të aeroplanëve F-16 këtë muaj në Danimarkë.
Ministri në detyrë i Mbrojtjes në Danimarkë, Troels Poulsen, ka thënë në muajin korrik se shteti pret "rezultate" nga trajnimi në fillim të vitit 2024.
Presidenti amerikan Joe Biden e ka përkrahur programin e trajnimit për pilotët ukrainas qysh prej majit. Përveç trajnimeve në Danimarkë, një qendër tjetër trajnuese ishte planifikuar të krijohej edhe në Rumani.
Një ditë më parë Kievi ka thënë se nuk pret që këtë vjeshtë dhe dimër t'i sigurojë aeroplanët F-16.
Zyrtarët amerikanë kanë thënë privatisht se F-16 do të mund t'i ofrojnë pak ndihmë Ukrainës në kundërofensivën e saj aktuale, e nuk do ta ndryshojnë tërësisht rrjedhën e luftës, për shkak të situatës me qiej të kontestuar mbi Ukrainë.

# Turqia paralajmëron Rusinë pas sulmit ndaj anijes në Detin e Zi

ANKARA, 18 GUSHT - Turqia ka paralajmëruar Moskën që ta shmangë përshkallëzimin e mëtejmë, pasi një anije furnizimesh, në pronësi turke, u sulmua fundjavën e kaluar nga marina ruse, tha zyra e presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan.
"Pas ndërhyrjes [ruse], bashkëbiseduesit tanë në Federatën Ruse u paralajmëruan në mënyrë që të shmangen përpjekje të tilla, të cilat përshkallëzojnë tensionet në Detin e Zi", tha Presidenca turke, duke thyer heshtjen disaditore për këtë incident.
Anija Sukru Okan po lundronte nën flamurin e Palauit dhe të dielën e kaluar një luftanije ruse shtiu drejt saj. Më pas personeli ushtarak rus kreu inspektime brenda anijes dhe më pas e la që të lundronte drejt portit ukrainas të Izmailit. Ky port është shndërruar në portin kryesor për eksportimin e produkteve bujqësore të Ukrainës.
Incidenti erdhi pas rritjes së sulmeve në rajonin e Detit të Zi. Sulmet u shtuan pas vendimit të Rusisë për t'u tërhequr muajin e kaluar nga marrëveshja që mundësonte eksportimin e sigurt të prodhimeve ukrainase.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Numri i policëve serbë të dorëhequr arrin në shtatë, Osmani: Pres nga BE-ja të ndërmarrë masa

"Epoka e re"

PRISHTINË, 18 GUSHT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të premten se numri i serbëve që kanë dhënë dorëheqje nga Policia e Kosovës në veri ka arritur në shtatë. Një ditë më parë është raportuar se tre pjesëtarë serbë të PK-së kanë dhënë dorëheqje nga ku institucion.

Në një konferencë për medie, pas vizitës në qytetin e Klinës, Osmani ka thënë se fajtori për këto dorëheqje është në Beograd. "Ka tashmë informata të konfirmuara, sipas hetimeve të institucioneve tona përgjatë këtyre javëve, që rrezikimi i këtyre pjesëtarëve, frikësimi, shantazhimi, vijnë drejtpërdrejt nga Serbia. Burimin e kanë në Serbi. Ky shtet, fatkeqësisht, vazhdon agresionin e hapur në raport me Kosovën. Po vazhdon që nëpërmjet institucioneve të veta ilegale dhe kriminale në Kosovë t'u bëjë presion qytetarëve serbë, të cilët janë pro-integrimit, të cilët janë pro-bashkëpunimit, dhe të cilët janë pro-shfrytëzimit të të drejtave që ua ofron atyre edhe Kushtetuta, por edhe Marrëveshjet e Brukselit", ka thënë Osmani.

Ajo i ka bërë thirrje Bashkimit Evropian ta dënojë presidentin serb Aleksandër Vuçiq për, siç ka thënë ajo, shkeljen e Marrëveshjeve të Brukselit. Mes të tjerash, Osmani ka thënë se në bashkëbisedime private me zyrtarë ndërkombëtarë ata e pranojnë se presioni ndaj policëve serbë në Kosovë vjen prej Serbisë dhe strukturave të saj. "Veprime të tilla janë shkelje flagrante e Marrëveshjeve të Brukselit, të cilat edhe kanë paraparë që një numër i policëve serbë të jenë të komuniteteve, pra të jenë serbë, varësisht nga kompozicioni i komunave. Unë pres nga BE-ja të ndërmarrë masa ndaj Serbisë dhe Vuçiqit për shkelje të marrëveshjes së Brukselit", ka thënë Osmani.

Dorëheqjen e policëve serbë e kanë komentuar më 17 gusht edhe diplomatë ndërkombëtarë që i përfaqësojnë vendet e tyre në Kosovë. Megjithatë, as Ambasada Amerikane në Prishtinë dhe as Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX) nuk i kanë përmendur arsyet që kanë rezultuar me dorëheqje.

Ministri për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës, Nenad Rashiq, u është drejtuar policëve të dorëhequr përmes një letre, duke u thënë se e di saktësisht me çfarë presioni janë përballur ata. "Fatkeqësisht, ndoshta nuk është asnjë serb i Kosovës që, të paktën, një herë në jetë të mos i ketë ndier personalisht kërcënimet e egra nga 'forca e padukshme malore', që shkatërron çdo vepër e çdo dëshirë për bashkëjetesë në Kosovën tonë të bukur, me metodat e saj shkatërruese".

Rashiqi ka thënë se do të angazhohet personalisht që t'u ndihmojë serbëve në Kosovë të triumfojnë ndaj "frikës, sfidave dhe dyshimeve".

Ndërkaq ambasadori britanik në Kosovë, Nicholas Abbott, shprehu shqetësimet për dorëheqjet e zyrtarëve serbë nga Policia e Kosovës. "Është në interesin e komunitetit që policët serbë të Kosovës të vazhdojnë të punojnë në veri të Kosovës dhe që punën ta bëjnë të lirë nga frikësimet e jashtme dhe të brendshme", shkroi ai në X.

Rreth 550 policë serbë në veri - në komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - patën dhënë dorëheqje kolektivisht nga Policia e Kosovës në nëntor të vitit të kaluar, në shenjë proteste ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për regjistrimin e makinave me targa ilegale serbe në RKS - Republika e Kosovës.

Pas dorëheqjeve, autoritetet në Kosovë patën shpallur konkurs për pranim të policëve të rinj, duke i punësuar 74 të tillë. Prej tyre, 46 është raportuar se kanë qenë nga komuniteti serb.

Integrimin e serbëve në Policinë e Kosovës e parasheh një marrëveshje e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel më 2013 me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve. Dy vendet janë pjesë e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja për normalizim të raporteve prej vitit 2011. Palët kanë nënshkruar një mori marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar.




## Zëdhënësi i BE-së thotë se themelimi i Asociacionit është një nga prioritetet urgjente

PRISHTINË, 18 GUSHT - Bashkimi Evropian (BE) ka thënë se themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është një nga prioritetet. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka thënë se zbatimi i shpejtë i marrëveshjes në rrugën drejt normalizimit është i ndërlidhur me procesin e anëtarësimit në BE. "Lidhur me marrëveshjen e Ohrit dhe aneksin e zbatimit të saj, të dyja palët e përkushtuara për të punuar në zbatimin e plotë dhe historia se si po ecin në zbatim tani është e lidhur drejtpërdrejt me procesin e tyre të anëtarësimit", ka thënë zëdhënësi i BE-së.

Ai ka thënë se "është thelbësore që dialogu i lehtësuar nga BE-ja dhe zbatimi i shpejtë i marrëveshjes në rrugën drejt normalizimit dhe aneksit të zbatimit të saj të vazhdojë". "Kjo përfshin themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe si një nga prioritetet urgjente", ka thënë Stano për "RTV21".






TRE TË ARRESTUAR TË DYSHUAR PËR KEQPËRDORIM TË REZERVAVE SHTETËRORE

# Opozita kërkon zgjedhje të reja pas arrestimeve në MINT dhe personave të afërt me pushtetin

Policia e Kosovës ka arrestuar të premten tre persona të dyshuar se kanë bërë keqpërdorime gjatë blerjeve të rezervave shtetërore në lidhje me aferën "Vaji". Dy prej të arrestuarve janë zyrtarë të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), ndërkaq njëri afarist, pronar i restorantit "Bukë e Zemër", i cili, sipas gazetës "Nacionale" që ka raportuar për këtë skandal, është i mik i ngushtë i kryeministrit Albin Kurti. Të arrestuarve u është caktuar masa e mbajtjes për 48 orë. Pas këtyre arrestimeve përfaqësuesit e partive opozitare kanë theksuar se kjo qeveri duhet të rrëzohet e vendi sa më shpejt duhet të shkojë në zgjedhje të reja

EPOKA E RE Mal QORRAJ

**Prishtinë, 18 gusht** - Policia e Kosovës ka arrestuar dje tre persona, të dyshuar se kanë bërë keqpërdorime sa iu përket blerjeve të rezervave shtetërore. Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se të arrestuarit dyshohen për veprat penale "keqpërdorim i detyrës zyrtare" dhe "dhënie e ndihmës në kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare".
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) konfirmoi se dy prej të arrestuarve janë zyrtarë të saj. Në një komunikatë për medie, Prokuroria Speciale, e cila e ka dhënë urdhrin për arrestime, ka njoftuar se të arrestuarit janë personat me inicialet R. M., H. G dhe I. L.
Të arrestuarve u është caktuar masa e mbajtjes për 48 orë.
Sipas raportimeve të medieve në Kosovë, i arrestuari i tretë është afaristi Ridvan Muharremi (pronar i restorantit 'Bukë e Zemër'), mik i afërt i kryeministrit Kurti, dhe në këtë rast ka dyshime për keqpërdorime në rezervat shtetërore.
Në njoftimin e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është përmendur edhe bastisja e disa ambienteve dhe sekuestrimi i provave materiale.
MINT tha se gjatë 18 gushtit janë kontrolluar zyrat e dy zyrtarëve të lartë të kësaj ministrie: të drejtorit të Departamentit të Rezervave Shtetërore, Hafiz Gara dhe të drejtorit të Departamentit për Integrime Evropiane, Irfan Lipovica. "Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë mirëpret çdo hetim për rastin e blerjes së rezervës shtetërore, ani pse ne jemi të bindur që furnizimet dhe rezerva shtetërore janë në përputhje me ligjet përkatëse, planin përkatës dhe asnjë dëm apo dëmtim nuk ka ndodhur me to", u tha në reagimin e MINT-it.
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë pret që organet e hetimit të kenë në vëmendje që krahas punës hetimore, të mos cenojnë në asnjë rrethanë sigurinë shtetërore për sa kohë që bëhet fjalë për rezervën shtetërore të republikës sonë, e klasifikuar sipas Ligjit për Rezervën Shtetërore dhe Ligjit për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar.
Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se duhet të pritet epilogu i rastit. "Për çdo proces të institucioneve të drejtësisë dhe institucioneve ligjzbatuese ne duhet ta presim epilogun e rasteve. Në këtë moment, nga informatat që i kemi, është e pamundur të paragjykohet epilogu i këtij rasti. Institucionet e kanë punën e tyre".

### Arrestimet ia hapin gojën opozitës

Partitë opozitare e kanë kritikuar qeverinë e udhëhequr nga Albin Kurti për, siç thanë, "skandalet dhe aferat korruptive". Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se keqqeverisja, e karakterizuar me skandale, afera, korrupsion, narkotrafikim dhe sanksione ndërkombëtare, duhet të marrë fund. Ai ka thënë se duhet të ketë zgjedhje të reja sa më parë. "Nëse nuk u kthehet mandati qytetarëve, shpejt dëmet e këtij mentaliteti shkatërrues do t'i vuajnë për dekada qytetarët dhe shteti ynë. Zgjedhje të reja sa më parë!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".
Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se degradimi i qeverisë ka arritur në përmasa enorme si në planin e brendshëm, po ashtu edhe në atë të jashtëm. "Përderisa kaq shumë zyrtarë qeveritarë dhe persona të afërt me qeverinë e partinë në pushtet janë të përfshirë në skandale të ndryshme, të padëgjuara më parë në Kosovë, atëherë akuzat drejtohen vetëm në një adresë. Koka dhe udhëheqësi i tyre është pikërisht ai që i ka angazhuar dhe i ka veshur me pushtet e përgjegjësi, kryeministri i vendit dhe kryetari i LV-së, Albin Kurti. Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një njeri të sëmurë për pushtet, të papërgjegjshëm dhe të pandërgjegjshëm, e që nuk dorëhiqet, obligohet mobilizimi i të gjithë atyre që e duan Atdheun dhe që përfaqësojnë interesat e vendit dhe qytetarëve pa dallime partiake", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".
Lideri i AAK-së ka thënë se thirrja e seancës së jashtëzakonshme për shkarkimin e qeverisë përmes mocionit të mosbesimit është zgjidhja e vetme për ta shpëtuar vendin dhe për t'i hapur rrugë qeverisë së unitetit kombëtar dhe zgjedhjeve të reja.
Berat Rukiqi nga Lidhja Demokratike e Kosovës ka mbajtur një konferencë për medie pas arrestimeve të fundit lidhur me aferën me rezervat shtetërore. Ai ka thënë se LDK-ja inkurajon organet e rendit dhe zbatimit të ligjit ta vazhdojnë

# Kurti të hënën në Greqi në darkën joformale për të ardhmen evropiane të Ballkanit Perëndimor

Prishtinë, 18 gusht - Kryeministri Albin Kurti do të marrë pjesë në një darkë joformale diskutimi mbi zgjerimin dhe të ardhmen evropiane të Ballkanit Perëndimor që do të organizohet nga kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis. Lajmi u dha nga mediet greke.

Shqipëria e ftuar në nivel presidenti nuk do të përfaqësohet në këtë takim, ndërsa nuk bëhet me dije nëse kjo është për shkak të ashpërsimit të gjuhës për rastin e kryetarit të Himarës, Fredi Beleri.

Agjencia e lajmeve ANA - MPA raporton se nisma e kryeministrit Mitsotakis për të ftuar të hënën më 21 gusht në orën 20:15 liderët e Ballkanit Perëndimor dhe vendeve anëtare të BE-së në Mansionin Maximos për një darkë joformale diskutimi mbi zgjerimin dhe të ardhmen evropiane të rajonit, nënvizon rolin e Greqisë si shtyllë për stabilitetin, paqen dhe sigurinë energjetike në Ballkan dhe në Evropën Juglindore.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen dhe presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, i janë përgjigjur pozitivisht ftesës së Mitsotakis diçka që është sa thelbësore dhe simbolike.

Përpos Kurtit, nga liderët rajonalë do të marrë pjesë edhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovaçevski, presidenti malazez Jakov Milatoviç, kryetarja e Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, Borjana Kristo, si dhe presidenti serb, ish-ministri i Millosheviqit, Aleksandër Vuçiq.

Në darkën joformale do të marrin pjesë edhe liderët e vendeve që janë anëtare të BE-së si kryeministri i Bullgarisë, Nikolai Denkov, i Kroacisë, Andrej Plenkoviq, dhe i Rumanisë, Ion-Marsel Ciolacu.






punën e tyre profesionale dhe të pavarur në këtë rast dhe në të gjitha rastet e tjera me elemente korruptive dhe kriminale. "Të gjitha faktet e publikuara deri tani na bëjnë të besojmë se në aferën e rezervave shtetërore kemi përfshirje të niveleve më të larta politike të kësaj qeverie, prandaj hetimi duhet t'i përfshijë këto nivele. Kërkojmë arrestimin e ministres Hajdari pas zhvillimeve të sotme. Dorëheqja nuk mjafton dhe i bëjmë thirrje pushtetit që të mos i pengojë hetimet", ka thënë Rukiqi.

Ai ka bërë me dije se me fillimin e sesionit të ri të Kuvendit të Kosovës, LDK-ja do ta kërkojë themelimin e Komisionit Hetimor për këtë aferë për, siç ka thënë ai, për ta adresuar qartë të gjithë përgjegjësinë politike të niveleve më të larta të pushtetit në këtë aferë milionëshe.

Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se kjo qeveri duhet të shkarkohet. "Vendit i duhen zgjedhje. Qeverisja e Albinit identifikohet me korrupsion, afera, sanksione, dështime", është shprehur Gashi.

Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka thënë se pushteti i Kurtit po zhvishet çdo ditë e më shumë nga petku moralist. Sipas tij, aferat korruptive janë bërë të përditshme në këtë qeveri. "Skandali nuk po e pret skandalin. E përgjigjja e Kurtit ndaj këtij fenomeni është problem më i madh se krimi e korrupsioni në vetvete. Qasja selektive e kryeministrit, ku korrupsioni i kryer në baza private dënohet - rasti i Besnik Mujecit, ndërsa korrupsioni prezent në instanca të larta shtetërore justifikohet dhe mbrohet - Martin Berishaj, Nagip Krasniqi, Berat Lahu e Rozeta Hjdari, është qasje edhe problematike dhe ideologjikisht e gabuar. E ftoj prokurorinë që të gjitha aferat korruptive t'i hetojë deri në fund", ka shkruar Molliqaj në "Facebook".

Drejtori i Institutit KIPRED, Lulzim Peci, ka komentuar arrestimin e tre personave të cilët dyshohen për keqpërdorimin të rezervave shtetërore. Ai ka treguar për problemin e aferave korruptive në Kosovë. Në "Facebook" Peci ka shkruar se në Kosovë zakonisht në burg përfundojnë hallkat më të dobëta të pushteteve. Sipas tij, ato të fortat mbesin të paprekura! "Problem i veçantë me aferat korruptive në Kosovë është se zakonisht në burg përfundojnë hallkat më të dobëta të pushteteve, ndërsa ato më të fortat mbesin të paprekura. Le të shohim se si do të përfundojnë edhe aferat e pushtetit të ri! Nuk jam optimist që do të kemi ndonjë ndryshim!", ka shkruar Peci.

## Komuna e Podujevës njofton se certifikata e pronës mund të tërhiqet në E-Kiosqe




PODUJEVË, 18 GUSHT - Komuna e Podujevës ka njoftuar se certifikata e pronës mund të tërhiqet në E-Kiosqe dhe ajo mund të nxirret vetëm me letërnjoftim. "Në kuadër të përmirësimit të shërbimeve administrative, nga tash e tutje qytetarët mund ta bëjnë edhe tërheqjen e certifikatës së pronës në E-Kiosqet të cilat janë të vendosura në katër lokalitete të ndryshme në komunën e Podujevës", ka njoftuar komuna e Podujevës.

# Lladrovci fton qytetarët të japin propozime për investime kapitale

Drenas, 18 gusht - Dëgjimet buxhetore me qytetarë janë pjesë e obligimit ligjor të pushtetit lokal. Në këto dëgjime pranohen propozime, jepen ide dhe sugjerime të qytetarëve për investime kapitale, ka thënë kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, në dëgjimet buxhetore për këtë vit.
Ai ishte i pranishëm në pesë takime, me pjesëmarrës të ndryshëm, grupe të interesit dhe qytetarë. "Falënderoj qytetarët, administratorët e fshatrave për praninë e tyre, për propozimet e debatet dhe besimin se kërkesat e tyre do të realizohen. Po ashtu, në takime kam theksuar se kemi buxhet dhe ai buxhet është në shërbim të projekteve për qytetarët. Ftojmë qytetarët të marrin pjesë në takimet e radhës sipas agjendës dhe kërkesat që nuk i kanë parashtruar në takime, t'i bëjnë brenda tri ditëve me shkrim në komunë, pranë drejtorive përkatëse", ka shkruar Lladrovci në "Facebook". Ai ka bërë me dije se buxheti për investime kapitale për vitin 2024 është 6,372,478.00 euro, ndërsa për vitin 2025 buxheti është 7,390,165.00 euro.






# Trafikut Urban në Prishtinë i shtohet edhe një shofere

Prishtinë, 18 gusht - Mehreme Brahimi është shoferja e tretë që i është bashkuar ekipit të ndërmarrjes së Trafikut Urban në Prishtinë.
Kryeshefi i Trafikut Urban, Burim Maraj, është shprehur i kënaqur me përparimet e ndërmarrjes në shumë segmente, në mesin e tyre edhe përfshirjen sa më të madhe të grave në pozita të ndryshme. Shërbimet me autobusë dhe angazhimi i stafit të tyre mirëpriten dhe vlerësohen edhe nga qytetarët që shfrytëzojnë këto shërbime, numri i të cilëve është duke u rritur dita-ditës.
Brahimi është punëtore e ndërmarrjes Trafiku Urban që nga viti 2019.

# Rama: Në disa lagje të Prishtinës ka rënë numri i vjedhjeve

Prishtinë, 18 gusht - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se në disa lagje të kryeqytetit ka rënë numri i vjedhjeve, në të tjera numri i tentimvrasjeve dhe vrasjeve, ndërsa në disa zona është ulur numri i rasteve të dhunës në familje. "Këto janë disa nga lajmet pozitive që i morëm nga policia sot gjatë mbledhjes së jashtëzakonshme të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Këto të dhëna na shtyjnë të punojmë edhe më shumë bashkë me policinë e institucionet e tjera të sigurisë e drejtësisë, që kryeqyteti ynë të jetë një vend plotësisht i sigurt për të gjithë ne. Por ndihmë të madhe mund të na ofroni ju qytetarë duke bashkëpunuar me ne", ka shkruar Rama në "Facebook".



## Komuna e Vushtrrisë blen autoambulancë të re



VUSHTRRI, 18 GUSHT - Komuna e Vushtrrisë ka blerë një autoambulancë të re e cila ka kushtuar 57 mijë euro. Kryetari i kësaj komune, Ferit Idrizi, ka thënë se ky hap është ndërmarrë për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët. "Me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët, si komunë kemi blerë një autoambulancë të re për QKMF-në e Vushtrrisë!", ka shkruar Idrizi në rrjete sociale.

# QKUK-ja: Njëmbëdhjetë raste me meningjit po trajtohen në Klinikën Infektive, situata është në kontroll

EPOKA E RE **F. DËRMAKU**

**Prishtinë, 18 gusht** - Në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës nga muaji korrik i këtij viti e deri më sot janë trajtuar 45 pacientë me meningjit te moshat pediatrike dhe 20 raste te të rriturit. Në dy muajt e fundit vërehet rritje e numrit të pacientëve krahasuar me muajt paraprakë, por situata është në kontroll të plotë dhe Klinika Infektive ka kapacitete të mjaftueshme profesionale dhe hapësinore për t'i trajtuar pacientët.
Aktualisht në Klinikën Infektive janë duke u trajtuar 11 raste me meningjit, dy prej tyre pediatrike.
Nga muaji janar deri në muajin korrik të këtij viti në trajtim ishin 38 pacientë.
Këto shifra u dhanë gjatë takimit që pati drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Elvir Azizi, me drejtorin e Klinikës Infektive, Arben Vishaj dhe stafin e klinikës.




Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës u bën thirrje qytetarët t'i respektojnë masat e rekomanduara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike.
Shkaktar i sindromës meningjeale janë infeksionet bakteriale ose virale, ndërsa si rrugë e përhapjes së infeksionit mund të jenë pishinat, vendet e freskimit, kontakti dhe uji për pije.

### Simptomat

Disa nga simptomat e sëmundjes janë të ngjashme me ato të një gripi normal, por që rëndohen për një kohë shumë të shkurtër. Meningjiti mund të shfaqet menjëherë ose 3-7 ditë pas marrjes së infeksionit. Te simptomat e sëmundjes përfshihen: të vjella, marramendje, temperaturë e lartë e trupit, dhimbje e muskujve, ndjeshmëri ndaj dritës, dhimbje e kokës, konfuzion, gjymtyrë të ftohta, skuqje e lëkurës.
Ndërsa te fëmijët mund të ketë edhe simptoma si frymëmarrja e shpejtuar, irritim dhe të qara për një kohë të gjatë, humbje të përqendrimit dhe mungesë oreksi.
Sapo t'i vëreni simptomat e mësipërme apo gjendje të rënduar shëndetësore, menjëherë duhet të konsultoheni me mjekun. Meningjiti trajtohet vetëm në spital.

# Tetë aparatura testimi për PCR i janë dhuruar IKShPK-së

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 18 gusht** - UNICEF-i, me mbështetjen e USAID-it, i ka dhuruar Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK),tetë njësi të pajisjeve më të avancuara për PCR. Këto pajisje do të luajnë rol vendimtar në avancimin e mbikëqyrjes, gatishmërisë dhe kontrollit të sëmundjeve.
Gjatë tri viteve të fundit UNICEF-i, së bashku me USAID-in, kanë qenë partnerë kyçë të Ministrisë së Shëndetësisë në përgjigjen ndaj pandemisë Covid-19. Me fokus në rritjen e qasjes në vaksina dhe testimin për Covid-19, bashkëpunimi ndihmoi për t'i ngritur kapacitetet e IKShPK-së për mbikëqyrjen e sëmundjeve dhe gatishmërinë për epidemi.
Kriza e Covid-19 shërbeu si përkujtues i fortë i nevojës urgjente për ta përmirësuar infrastrukturën e shëndetit publik për t'i menaxhuar në mënyrë më efektive sfidat e paparashikuara shëndetësore. Duke ditur situatën aktuale në infrastrukturën për mbikëqyrjen e sëmundjeve, përpjekjet e përbashkëta të UNICEF-it, USAID-it dhe IKSHPK-së synuan të adresojnë këtë mungesë në sistemin shëndetësor publik të Kosovës.
Ky donacion i pajisjeve moderne, i mundësuar nga teknologjia PCR në kohë reale, nuk kufizohet vetëm në testimin e Covid-19, por mundëson zbulimin e shpejtë të një spektri sëmundjesh të frymëmarrjes, duke përfshirë gripin dhe Streptokokun A, si dhe sëmundje të tjera infektive si tuberkulozi.



Gjithsej, tetë njësi të tilla me vlerë prej 365 000 dollarësh amerikanë janë dorëzuar në IKShPK në korrik të vitit 2023, për t'u përdorur në Institutin Qendror, në gjashtë qendra rajonale dhe në laboratorin e Klinikës Infektive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

## Më 27 shtator mbahet simpoziumi ndërkombëtar i sëmundjeve kronike jongjitëse




**Prishtinë, 18 gusht** - Më 27-29 shtator në Kosovë mbahet Simpoziumi Ndërkombëtar treditor për Sëmundjet Jo-Ngjitëse (SJN). Nikoqirë të kësaj ngjarjeje janë Ministria e Shëndetësisë në Kosovë në bashkëpunim me Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).
Qëllimi është të shkëmbehen praktikat më të mira, të përfshihen informata në planin e Kosovës për SJN-të dhe të gjenerohen veprime dhe rekomandime të qëndrueshme për trajtimin e sfidave të SJN-ve.
Simpoziumi është i akredituar nga Oda e Mjekëve dhe Oda e Infermierëve në Kosovë. Ngjarjen pritet ta përcjellin rreth 500 pjesëmarrës, përfshirë folës të mirënjohur ndërkombëtarisht. Organizimi i këtij simpoziumi fasilitohet bashkërisht nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe projektet e SDC-së në Kosovë Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor dhe Shërbimet Shëndetësore të Integruara.

# Kompensimi i munguar për vdekjen në vendin e punës

**PRISHTINË, 18 GUSHT** - Njoftimet për vdekjet e punëtorëve në vendet e tyre të punës, Milaim Ibriqit ia rikthejnë skenat dhe momentet kur mësoi për humbjen e vëllait të tij, Kujtimit. Kujtim Ibriqi, 44 vjeç nga fshati Komoran, komuna e Drenasit, humbi jetën në vendin e tij të punës në prill të këtij viti. Ai la pas gruan dhe dy fëmijë.

Milaim Ibriqi kujton edhe bisedat me vëllanë e tij për kushtet e punës.

Kujtimi punonte në një kompani private në sektorin e ndërtimit. "Edhe çizmet e punës, në disa raste, i ka blerë me para të veta. Kompania nuk i ka ofruar kurrfarë kushtesh, as kapelë e as rrip mbrojtës. Asgjë. Por, kushtet e vështira [ekonomike] e kishin detyruar që të punonte për ta siguruar ekzistencën e familjes", thotë Milaim Ibriqi për "Radion Evropa e Lirë".

Humbja e Kujtimit nuk mund të kompensohet, thotë vëllai i tij. Por, ai shton se një kompensim financiar nga kompania ku Kujtimi ka punuar, do ta lehtësonte sadopak gjendjen sociale të familjes së tij, pasi gruaja e Kujtimit është e papunë dhe dy fëmijët janë të mitur.

Që nga vdekja e Kujtimit, Milaimi e ka ndërprerë punën, pasi edhe ai punonte në sektorin e ndërtimtarisë. "Për ceremoninë e varrimit kemi marrë një shumë të mjeteve të nevojshme për mbulimin e shpenzimeve për atë ditë. Më, asnjë cent. Tani lënda ka shkuar në gjykatë. Kur të na thërrasin, do të shkojmë dhe do të shikojmë se çfarë do të vendoset", tregon ai.

Sipas Inspektoratit të Punës, vetëm gjatë këtij viti, 12 persona kanë vdekur në vendin e tyre të punës. Një vit më parë, ky numër ishte 14. "Nga ky numër, pesë raste nga Inspektorati janë cilësuar vdekje si rezultat i drejtpërdrejtë i ushtrimit të veprimtarisë së punës dhe shtatë raste të tjera nuk lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së punës", thuhet në përgjigjen e Inspektoratit të Punës dërguar "Radios Evropa e Lirë".

Por, shifrat zyrtare për vdekjet e personave në vendet e tyre të punës ndryshojnë nga të dhënat e Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat.

Udhëheqësi i kësaj sindikate, Jusuf Azemi, thotë se vetëm



gjatë këtij viti, 17 persona kanë humbur jetën në vendin e tyre të punës.

Ai thotë se këto raste vdekjesh duhet të jenë alarm veprimi për institucionet e Kosovës. Sipas Azemit, duhet të shtohen kontrollet në sektorin e ndërtimtarisë, në mënyrë që të përmirësohen masat mbrojtëse për sigurinë e punëtorëve.

Vitin e kaluar, Inspektorati i Punës ka kryer 6.316 inspektime. Sipas raportit vjetor të këtij institucioni, gjatë kësaj periudhe janë trajtuar me prioritet rastet e aksidenteve në vendet e punës. Sipas këtij raporti, më 2022 në Kosovë kanë ndodhur 394 aksidente, prej të cilave 15 kanë përfunduar me fatalitet.

Azemi nga Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat u shpreh kritik, pasi pas rasteve që përfundojnë me fatalitet, kompanitë private e as institucionet nuk i kompensojnë familjarët e viktimave. "Deri më tani, Qeveria e Kosovës dhe Inspektorati i Punës nuk kanë bërë asgjë. Dhe, ajo që është më e keqja, gjithkund, në këto raste qeveritë kanë fonde të veta për një mbështetje financiare derisa të vërtetohet nëse është fajtor pronari i kompanisë ose kushdo qoftë tjetër. Por, në momentin që vdesin këta punëtorë, familjarët e tyre mbesin pa asnjë mbështetje financiare dhe ligjore", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Sektori privat në Kosovë llogaritet punëdhënësi më i madh. Numri i të punësuarve vlerësohet të jetë mbi 220.000. Paga mesatare, sipas të dhënave për vitin e kaluar, ka qenë rreth 480 euro.

Punonjësit në sektorin privat vazhdimisht janë ankuar për mosrespektim të të drejtave të tyre.

## Aksidentet në vendin e punës

Gjatë dhjetë vjetëve në Kosovë kanë humbur jetën 147 punëtorë në vendet e tyre të punës, kurse janë lënduar 933 punëtorë. Shumica e këtyre rasteve kanë ndodhur në sektorin privat. Përfaqësues të Sindikatës së Sektorit Privat konsiderojnë se këto shifra duhet të jenë alarm për institucionet dhe kompanitë që të veprojnë për t'i rritur masat e sigurisë në vendin e punës.

# Hapen thirrjet për subvencionim të pajisjeve shtëpiake efiçiente dhe sistemit diellor për ngrohjen e ujit sanitar

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**




**PRISHTINË, 18 GUSHT** - Ministria e Ekonomisë ka shpallur thirrjet për mbështetjen e konsumatorëve familjarë në investimin në pajisje shtëpiake efiçiente dhe për mbështetjen e konsumatorëve familjarë në investimin në sisteme të energjisë së ripërtrishme - sistemi diellor për ngrohjen e ujit sanitar.

Masat e efiçencës u prezantuan të premten nga kryeministri Albin Kurti, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe Alessandro Bianciardi nga Zyra e BE-së në Kosovë.

Në thirrjen për mbështetjen e konsumatorëve familjarë në investimin në pajisje shtëpiake efiçiente përfshihet subvencionimi i makinave rrobalarëse, makinave enëlarëse dhe frigoriferëve ose frigoriferëve me ngrirëse.

Vlera e subvencionimit për një pajisje makinë rrobalarëse është 200.00 euro. Për prindërit vetushqyes vlera e subvencionimit për një pajisje është 300.00 euro. Për qytetarët që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale (kategoria I & II) vlera e subvencionimit për një pajisje është 400.00 euro.

Vlera e subvencionimit për një pajisje makinenëlarëse është 150.00 euro. Për prindërit vetushqyes, vlera e subvencionimit për një pajisje është 250.00 euro. Për qytetarët që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale (kategoria I & II), vlera e subvencionimit për një pajisje është 300.00 euro.

Vlera e subvencionimit për një pajisje frigorifer ose frigoriferëve me ngrirëse është 100.00 euro. Për prindërit vetushqyes vlera e subvencionimit për një pajisje është 150.00 euro. Për qytetarët që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale (kategoria I & II), vlera e subvencionimit për një pajisje është 200.00 euro.

Për mbështetjen e konsumatorëve familjarë në investimin në sisteme të energjisë së ripërtërishme - sistemi diellor për ngrohjen e ujit sanitar - instalimi i sistemit diellor për ngrohjen e ujit sanitar, do të subvencionohet vetëm një sistem diellor për ngrohjen e ujit sanitar për një shtëpi dhe sistemi duhet të blihet i ri. Instalimi i sistemit diellor për ngrohjen e ujit sanitar subvencionohet 40 për qind e vlerës investive të komplet sistemit diellor për ngrohjen e ujit sanitar dhe jo më shumë se 1000.00 euro.

Për të dy thirrjet të drejtë aplikimi kanë të gjithë konsumatorët familjarë, konsumi mujor i energjisë elektrike i të cilëve nuk është më i vogël se 250 kWh/muaj në të paktën dhjetë muaj brenda dymbëdhjetë muajve të fundit.

Aplikimi për subvencionim bëhet online përmes platformës e-Kosova.

# Ditët shqiptare të Melonit, që bënë të shpërthejnë thashethemet mbi varka dhe takime të fshehta



Misteri i kësaj vere duket sikur u shpërnda disi dje, kur burime të sigurta të shtypit bënë me dije që Kryeministrja Meloni u rikthye në Pulia pas tre ditësh qëndrim në Shqipëri.

Lumenj të tërë boje, pyetje, insinuata mbi arsyet e vërteta të vizitës në vendin e shqiponjave. Me çfarë mjetesh lëvizi? Kush ishte bashkë me të? Ku qëndroi dhe me kë u takua gjatë vizitës së shkurtër, të ndarë mes Vlorës dhe rezidencës verore të Kryeministrit shqiptar, Edi Rama në Dhërmi?

Në mbrëmje, misterin ka menduar ta zbulojë edhe vetë kryeministri shqiptar. E ka bërë duke ndarë në rrjetet sociale një fotografi ku shfaqet bashkë me Melonin, të dy duke buzëqeshur, me pantallona të errëta dhe këmishë të bardhë. Më tej, falënderimi në italisht: "Motër e Shqipërisë. Vëlla i Italisë. Faleminderit Giorgia, ishte një nder!".

Por, ja kronologjia e blitz-it të këtij mesi gushti: Meloni mbërriti të hënën në Vlorë, me një traget të nisur nga Brindizi. U prit nga homologu i saj shqiptar, Rama, i cili disa ditë më herët e kishte ftuar që të kalonte disa ditë pushime në brigjet shqiptare, që këtë vit si kurrë më parë, kanë qenë një destinacion i preferuar edhe për shumë turistë italianë.

Nga Vlora është zhvendosur disa kilometra më në jug, në zonën bregdetare të Dhërmiut, ku ndodhet rezidenca verore e kryeministrit shqiptar.



Salta, a meno di nuovi colpi di scena, il combattimento ‹epico› fra Elon Musk e Mark Zuckerberg, che si sarebbe dovuto tenere in Italia in una location che richiamasse i fasti dell'Antica Roma, per un evento di beneficenza con il consenso del Mic. Musk, in un post su X, l'ex Twitter, scrive direttamente al nostro ministro della Cultura: ‹Voglio ringraziare il ministro Sangiuliano per la gentilezza e la disponibilità nel voler organizzare un evento di intrattenimento, culturale e di beneficenza in Italia. Zuckerberg ha rifiutato perché non è interessato a questo approccio. Vuole solo combattere se è la Ufc a organizzare l'incontro›

**SINTONIA** La foto pubblicata dal premier albanese Edi Rama per ringraziare Giorgia Meloni della visita in Albania. La presidente del Consiglio, insieme alla sua famiglia, ha passato qualche giorno a Valona: ‹Grazie Giorgia, è stato un onore›, il messaggio a corredo dello scatto

**Domenico Di Sanzo**

IL CASO

## E qualche giorno di vacanza in Albania scatena il gossip su barche e incontri

*La premier ospite del collega Edi Rama, ieri è rientrata in Puglia*

Il giallo di carta dell'estate si dissipa ieri pomeriggio, quando fonti di stampa fanno sapere che la premier Giorgia Meloni è rientrata in Puglia dopo tre giorni in Albania.

Fiumi d'inchiostro, domande, insinuazioni sulle reali motivazioni della visita nel Paese delle Aquile. Con quali mezzi si è spostata? Chi c'era insie-

Fratello d'Italia. Grazie Giorgia, è stato un onore». Ma ecco la cronologia del blitz ferragostano: Meloni arriva lunedì

mai come quest'anno una meta gettonatissima anche da molti turisti italiani. Da Valona lo spostamento di una qua-

ca insieme alla famiglia, come testimoniato dalle immagini dell'emittente albanese Rtv Klan, in cui si intravedevano

cottero a Himare, vicino Dhermi, l'ex premier laburista inglese Tony Blair. Blair attualmente fa il consulente e lavora anche per Rama. E sono circolate voci su una cena tra Meloni e l'ex leader britannico a Valona, la sera di Ferragosto.

Quel che è certo è che la premier sta trascorrendo le sue ferie in Puglia, alla masseria Beneficio di Ceglie Messapica, in provincia di Brindisi.

